



RAPORTI 10 VJEÇAR
I ASOCIACIONIT
NACIONAL TË AUTIZMIT
NË KOSOVË (**ANAK**)

PËRMBAJTJE

FJALA HYRËSE	06
ASOCIACIONI NACIONAL I AUTIZMIT NË KOSOVË	07
Vizioni	
Misioni	
Struktura Organizative	
Bordi	
Kuvendi	
Personeli kyç	
Objektivat vepruese strategjike të ANAK	
Objektivi Strategjik I: Ofrimi i shërbimeve profesionale direkte terapeutike	
Objektivi Strategjik II: Integrimi dhe gjithpërfshirja	
Objektivi Strategjik III: Avokimi	
Objektivi Strategjik IV: Edukimi	
Objektivi Strategjik V: Menaxhim efektiv dhe efikas i organizatës	
Objektivi Strategjik VI: Qëndrueshmëria	
INFORMATA TË PËRGJITHSHME RRETH AUTIZMIT	17
Përceptimi për personat me autizëm	
Mundësitë e punësimit për personat me autizëm	
ANGAZHIMI I ANAK	19
Rezultatet konkrete	
Shërbimet dhe Aktivitetet Specifike të ANAK	
Intervenimet terapeutike	
Aktivitete terapeutike në ambiente të jashtme	
Reduktimi i sjelljeve problematike të fëmijëve në ANAK	
Zhvillimi i komunikimit tek fëmijët në ANAK	
Integrimi i fëmijëve me autizëm në sistemin edukativ	
Trajnime dhe Diskutime	
Praktika dhe Vullnetarizimi	

BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL	39
Departamenti i Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës Instituti i Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit Qendrat për Punë Sociale Drejtoria e Mirëqenies Sociale, Komuna e Prishtinës	
INICIATIVA INDIVIDUALE PËR MBËSHTETJE TË ANAK	41
Përkrahja nga Sunny Hill Foundation dhe Dua Lipa Vrapo për autizëm	
SFIDAT NDËR VITE	43
ANAK NË VITET E ARDHSHME	44
DONATORËT E PËRGJITHSHËM TË ANAK 2012-2022	47
Projektet ekzistuese Mbështetësit tjerë ndër vite	

Fjala Hyrëse



JETA DEVA

MR. SPEC PSIKOLOGE
KLINIKE
DREJTORE EKZEKUTIVE

Muaji prill 2022, shënjon plot një dekadë qëkur ANAK u themelua dhe filloi punën me ofrim të shërbimit direkt terapeutik për fëmijët me autizëm në Kosovë. Janë dhjetë (10) vite të sakrificës, punës së palodhshme, pasionit dhe përkushtimit të pandalshëm të të gjithë stafit në arritje të rezultateve sa më të mira. Por janë edhe dhjetë (10) vite të mbushura me gëzim, shpresë dhe motivim, të cilat rrjedhin nga dhjetëra e qindra fëmijë, jeta e të cilëve ka ndryshuar e vazhdon të ndryshoj për të mirë.

ANAK filloi punën në një kohë kur autizmi në Kosovë përballëj me probleme të shumfishta dhe shumë-shtresore, të cilat e bënin punën jashtëzakonisht të vështirë. Mungesa e vetëdijës shoqërore, stigmatizimi i personave me autizëm, mungesa e shërbimeve arsimore përcjellëse për fëmijët me autizëm nëpër shkollë, mungesa e investimeve shtetërore në ofrimin e shërbimeve cilësore, mes të tjerash, janë probleme me të cilat ANAK është marrë që nga dita e parë e themelimit.

Por pikërisht këto kanë qenë themeli i motivit dhe përkushtimit të ANAK për të shtyrë gjërat përpara, për të përfshirë sa më shumë fëmijë me autizëm në shërbime terapeutike dhe vijim shkollor, kështu duke punuar për të mos lënë asnjë fëmijë me autizëm pa marrë shërbimin e duhur dhe esencial. Kjo betejë ende vazhdon.

Për ANAK, ky ka qenë një rrugëtim dhjetëvjeçar i mësimi, ku ne kemi pasur privilegjin të zhytmi në botën e bukur të autizmit, ku fëmijët kanë nxjerrë fjalët e para, janë aftësuar të komunikojnë, dhe kanë fituar një pavarësi për jetën e tyre. Në fund, çdo punë, përpjekje e sakrificë duket shpërblim kur sheh një fëmijë të nxjerrë fjalën e parë nga goja.

Natyrisht që e gjithë kjo punë nuk do të ishte e mundur pa punën e vetëmohueshme të personelit të ANAK, si dhe pa angazhimin dhe përkushtimin e prindërve të fëmijëve, të cilët përgjatë viteve kanë pasur besimin e plotë në ANAK dhe kanë treguar vendosmërinë për të përcjellë këshillat profesionale, dhe për të vazhduar metodologjinë terapeutike në familjet e tyre.

Me gjithë sfidat dhe vështirësitë, ANAK sot është më e fuqishme dhe më e qëndrueshme se asnjëherë më parë. Institucionet publike, donatorë të ndryshëm, biznese private, e edhe mbështetës individual gjithnjë e më shumë i kanë dal në ndihmë ANAK. Dhe për këtë jemi falënderues. Të gjithë janë kontribues në suksesin e sotëm të ANAK.

Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë

Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë - ANAK, është organizatë joqeveritare e themeluar në janar 2012 me mbështetjen e profesorëve të Departamentit të Psikologjisë dhe Edukimit, në kuadër të së cilës është bërë i mundur ofrimi i shërbimeve individuale për fëmijët me autizëm me parimet themelore të terapisë së sjelljes dhe sjelljes verbale, si dhe është mundësuar trajnimi sistematik i familjeve të atyre fëmijëve.

Që nga themelimi i saj, ANAK prioritet të palëkundur ka cilësinë e terapisë individuale, me ç'rast fokusin e intervenimit e ka bazuar në principet e terapisë së Analizës dhe Aplikimit të Sjelljes dhe Sjelljes Verbale, si metoda të treguara shkencërisht efektive. Përveç terapisë direkte me fëmijët me autizëm, terapistët në baza ditore raportojnë verbalisht tek prindërit e fëmijëve, mbikëqyrin zhvillimin e fëmijëve, shqyrtojnë prioritetin e nevojave të fëmijëve, si dhe fusin të dhënat në sistemin e brendshëm shkencor E-Data në mënyrë longitutinale.



ANAK NË VITIN 2012



ANAK NË VITIN 2022

Për të realizuar dhe për të ndërlidhur zinxhirin e nevojave që një person me autizëm dhe familja e saj/tij e ka, ANAK në mënyrë të vazhdueshme ka ofruar: vlerësim klinik zhvillimor, plan individual të punës,

trajnime të prindërve bazuar në planin individual të punës, shërbimin direkt profesional në baza ditore, konsulta të rregullta të prindërve si dhe konsulta të mësuesve në shkollë në rastet kur fëmija ka arritur të integrohet në sistemin e rregullt edukativ.

Përveç shërbimeve direkte profesionale, ANAK që nga thelemimi i saj ka kontribuar sistematikisht në vetëdijësim të shoqërisë mbi autizmin dhe shkathtësitë unike që mund t'i kenë, duke e mirëmbajtur një rrymë të vetëdijësimit pa viktimizim. Gjithashtu, në mënyrë të vazhdueshme ANAK bën influencimin dhe promovimin e vullnetarizmit si dhe avokimin institucional në betejën për të drejtat e personave me autizëm dhe familjet e tyre.

ANAK vazhdon të siguroj qëndrueshmërinë e saj më së shumti nga kontributet minimale të prindërve dhe profesionalizmi i stafit të saj, e në anën tjetër me ndihmën e donatorëve të ndryshëm arrin t'i mbulojë edhe disa shpenzime dhe ofrim të shërbimeve shtesë dhe falas për fëmijët në kuadër të qendrës.

VIZIONI & MISIONI

**NJË SHOQËRI QË
U SIGURON JETË
CILËSORE DHE TË
DREJTA TË
PLOTA PERSONAVE
ME AUTIZËM**

VIZIONI


Vizioni i ANAK është që të jap kontribut sistematik dhe cilësor për krijimin e kushteve të favorshme dhe të përshtatshme për personat me autizëm që të marrin shërbimet për të cilat kanë nevojë dhe kontribon që personat me autizëm të gëzojnë të drejtat dhe mundësitë të cilat i gëzojnë të gjithë pjesëtarët e tjerë të shoqërisë. ANAK do të punoj për një të ardhme ku të gjithë personat me autizëm marrin shërbime profesionale ditore dhe janë të pranuar dhe të respektuar në shoqëri.

MISIONI

ANAK synon përmbushjen e misionit të vet, përmes: ofrimit të shërbimeve direkte profesionale (vlerësimeve, shërbimeve direkte në baza ditore, konsultave profesionale, etj); integritit e gjithëpërfshirjes (asistenca në integrimin e fëmijëve me autizëm në sistemin edukativ dhe në përgjithësi në sistemin shoqëror); ofrimit të trajnimeve (organizimi i trajnimeve dhe punëtorive për profesionistë dhe prindër të fëmijëve me autizëm); përkthimeve (përkthime të vazhdueshme të literaturës mbi autizmin, metodat e përdorura për punë me rastet e autizmit dhe materiale tjera relevante

lidhur me autizmin); hulumtimeve (hulumtime të vazhdueshme mbi numrin e personave me autizëm, shërbimet ekzistuese dhe të nevojshme si dhe çështje tjera që lidhen me autizmin); publikimeve (publikim të raporteve në baza vjetore dhe të materialeve tjera me rëndësi për autizmin); kampanjave vetëdijësuese (konferenca për media, fletëpalosje, dokumentarë, etj); avokimit (bashkëpunimi me insitucione relevante në nivel qeveritar dhe jo qeveritar për ngritje të kapaciteteve të shërbimeve për autizëm) dhe aktiviteteve tjera relevante.

STRUKTURA ORGANIZATIVE



Kuvendi ANAK

- 1 **MIMOZA GASHI**, Magjistre dhe Specialiste e Psikologjisë Klinike, bashkëthemeluese e ANAK, zhvilluese e programeve të ANAK. Përvojë mbi 17 vjeçare në trajtime profesionale
- 2 **AFËRDITA GOÇI**, Psikiatre e fëmijëve dhe e të rriturve, bashkëthemeluese e ANAK me përvojë mbi 18 vjeçare si specialiste e psikiatrisë
- 3 **JETA DEVA**, Magjistre e Psikologjisë dhe Specialiste e Psikologjisë Klinike, bashkëthemeluese e ANAK dhe Drejtoreshë Ekzekutive. Përvojë mbi 17 vjeçare në trajtim të autizmit,
- 4 **VIGAN BEHLULI**, Magjistër dhe Specialist i Psikologjisë Klinike. Përvojë mbi 17 vjeçare në hulumtime dhe me përvojë disa vjeçare në intervenime psikoterapeutike,
- 5 **VLORA ISUFI**, Psikologe dhe ish implementuese e punës terapeutike në ANAK. Përvojë 8 vjeçare në punë me fëmijë me autizëm.

Bordi ANAK

- 1 **MOSHE LANDSMAN**, Doktor i shkencave (PHD), bashkëthemelues i Departamentit të Psikologjisë së Universitetit të Prishtinës dhe profesor i psikologjisë në UP dhe psikoterapeut për komunitetin e përgjithshëm në Kosovë që nga viti 2000. Përvojë 51 vjeçare në fushën profesionale.
- 2 **ARIANA SHALA**, Magjistre dhe Specialiste e Psikologjisë Klinike, Kryerate e Bordit të ANAK. Përvojë mbi 15 vjeçare në intervenime psikoterapeutike,
- 3 **ALIRIZA ARËNLIU**, doktor i shkencave (PHD), bashkëthemelues i Departamentit të Psikologjisë së Universitetit të Prishtinës dhe bashkëthemelues i Institutit të Psikologjisë. Profesor i psikologjisë në UP që nga viti 2001.

Personeli kyç

Drejtoresha ekzekutive e ANAK ka rol mbikqyrës të të gjitha shërbimeve të ofruara nga organizata dhe është përgjegjëse për mbarëvajtjen e punës së organizatës në përgjithësi. Drejtoresha ekzekutive, përveç të tjerave, ka edhe rolin e promovimit të punës së organizatës dhe rritjen e fondeve të cilat mundësojnë shërbime pa pagesë për fëmijët me autizëm dhe familjarët e tyre si dhe trajtimin e autizmit në të gjitha nivelet.

Pothuajse të gjithë të punësuarit në ANAK janë të angazhuar kryesisht si implementues të punës terapeutike gjatë shërbimeve direkte ditore. Përveç terapistëve kryesorë, në ANAK janë të angazhuar edhe asistentë të cilët mbështesin punën terapeutike gjatë shërbimeve ditore. Në vazhdimësi intervizioni në mes personelit profesional dhe procesi i mbikqyrjes së metodave të përdorura, janë pjesë e pandashme e të gjithë procesit terapeutik në ANAK.

Puna intenzive dhe fisnike e personelit të ANAK, ka bërë që kjo organizatë të mirëmbanë armën e saj më të fortë 'ruajtjen e shenjtë të kualitetit të punës individuale', duke u bazuar në shifra të kufizuara, mirëpo me rezultate të prekshme. Sfidimi i sjelljeve problematike të fëmijëve arrihet nga besimi i terapistëve të ANAK në efektin e qartë të metodave të Analizës së Sjelljes. Njohja e kapaciteteve unike të fëmijëve më të cilët punohet, stimulon edhe më tej qëndrueshmërinë këmbëngulëse të punës profesionale në ANAK.

Objektivat vepruese strategjike të ANAK

OBJEKTIVI STRATEGJIK I: OFRIMI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE DIREKTE TERAPEUTIKE

Ofrimin e shërbimeve profesionale direkte terapeutike individuale për personat me autizëm dhe familjarët e tyre me qëllim që të kontribuoj në përmbushjen e boshllëkut institucional dhe përmirësimin konkret të cilësisë së jetës së personave me autizëm dhe integrimin e tyre në shoqëri, veçanërisht duke u fokusuar në integrimin në institucionet shkollore të cilat fëmijët me autizëm i vijojnë.



OBJEKTIVI STRATEGJIK II: INTEGRIMI DHE GJITHPËRFSHIRJA

ANAK funksionon si urë lidhëse në mes të kopshteve, shkollave dhe fëmijëve me autizëm dhe familjarëve të tyre, duke punuar paraprakisht me fëmijët në mënyrë që ata të jenë më të gatshëm për integrim në sistemin e rregullt edukativ. ANAK vazhdimisht punon të mirëmbajë dhe krijojë bashkëpunime të reja me personele të institucioneve të ndryshme, duke u thirrur në rregulloret relevante që janë të zbatueshme, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve me autizëm, integrimin dhe përfshirjen e tyre pa diskriminim.



ANAK gjithashtu kontribuon në ngritjen e kapaciteteve të edukatorëve dhe mësimeve në kopshte dhe shkolla rreth autizmit, duke u fokusuar specifiku në përdorimin e metodave adekuate efektive të trajtimit dhe mbështetjes së fëmijëve me autizëm.

OBJEKTIVI STRATEGJIK III: AVOKIMI

Duke marrë parasysh që incidenca e autizmit në botë është 1 në 110 fëmijë dhe duke marrë parasysh mungesën e shërbimeve individuale për ata fëmijë, është i domosdoshëm vazhdimi i avokimit për pako bazike brenda shërbimeve esenciale publike. ANAK synon që deri në vitin 2023, secilin fëmijë me autizëm t'i mbulohen vlerësimet për nivelin e zhvillimit të tyre, planet individuale, seancat e rregullta javore për secilin fëmijë dhe trajnimet për secilën familje. Qëllimi i ANAK është që të arrihet gjithpërfshija dhe qasja në shërbime për të gjithë fëmijët, duke e reduktuar diskriminimin në baza ekonomike dhe sociale.

ANAK ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për Vlerësimin, njohjen e statusit, përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, si dhe ka prezantuar rekomandime gjatë draftimit të tij. Mirëpo, është e domosdoshme që të bëhet një avokim i gjithmbarshëm së bashku me organizata tjera, të cilat kanë identifikuar sfida me të cilat përballen fëmijët me autizëm dhe familjarët e tyre dhe nevojat që ata kanë. Me miratimin e këtij ligji në Kuvendin e Qeverisë së Kosovës, do të lehtësohej dukshëm mbingarkesa financiare e familjeve drejt krijimit të mundësive për zgjedhje të shërbimit cilësor, duke krijuar kështu hapësirë për punësimin e familjarëve të atyre fëmijëve. Në anën tjetër, edukatorët dhe mësimeve do të kenë mbështetje stabile nga asistentët e mbështetur nga institucionet publike.

ANAK konsideron që autizmi duhet të jetë fokus për realizimin e të drejtave të barabarta dhe të punohet seriozisht në përmbushjen e sigurimeve shëndetësore, për të cilën çështje ANAK ka avokuar në partneritet me Solidar Suisse, për vite me radhë. Gjithashtu është i domosdoshmëm planifikimi konkret për tranzicionin e shërbimeve për të rriturit me autizëm, përmes integritit të orientuar në komunitet.

OBJEKTIVI STRATEGJIK IV: EDUKIMI

ANAK ka për qëllim edukimin e profesionistëve të ardhshëm mbi autizmin përmes organizimit të trajnimeve për studentë të psikologjisë, edukimit dhe logopedisë. ANAK

gjithashtu synon që të krijoj një sistem më të organizuar të mbikëqyrjes profesionale dhe punës praktike të tyre.

Përmes prezantimeve të rregullta në media dhe përmes rritjes së dukshmërisë, ANAK do të vazhdoj të ndikoj në rritjen e vetëdijësimit mbi autizmin tek një pjesë më e madhe e shoqërisë, duke përfshirë këtu edhe diskutimet e rregullta nëpër shkolla me nxënës dhe mësime të ndryshme dhe me kampanja të ndryshme vetëdijësuese.

Për më shumë, ANAK do të vazhdoj të bëjë mbledhjen e të dhënave të progresit të fëmijëve, ku në bashkëpunim me hulumtues të ndryshëm të fushave sociale dhe shkencore, të krijoj një themel, ku përdorimi i metodave të ndryshme në punë nga gjetjet e matura në kontekstin e Kosovës, sidomos rastet e suksesit, janë më të besueshme për motivim.

OBJEKTIVI STRATEGJIK V: MENAXHIM EFEKTIV DHE EFIKAS I ORGANIZATËS

Nga sfidat e ndryshme, ANAK vlerëson që menaxhimi efektiv dhe efikas është parakusht i funksionimit të duhur i të gjithë organizatës, përfshirë ofrimin e shërbimeve apo avokimin për avancimin e të drejtave të personave me autizëm. Për këtë arsye, ANAK planifikon të rris angazhimin në trajtimin e kësaj çështje, përmes rritjes së burimeve njerëzore të dedikuara për këtë pjesë të punës, ashtu edhe përmjet rritjes së kapaciteteve të stafit tjetër për detyra të caktuara menaxheriale. Kjo do të shoqërohet edhe me avancimin e dokumenteve të brendshme dhe praktikave të punës, me synim qartësimin e përgjegjësive dhe rritjen e efikasitetit të punës në përgjithësi.

Futja e të dhënave për të matur sistematikisht progresin e procesit terapeutik në programin E-data plus, bëhet nën mbikëqyrjen e vazhdueshme për secilin hap, të secilës objektivë nga planet individuale të secilit fëmijë. Ky program mirëmbahet nga krijuesi i tij, Dr. Neil Martin, drejtor i zhvillimit ndërkombëtar për Bordin e Certifikimit të Analistëve të Sjelljes (Board Certified Behavior Analyst (BCBA). Të dhënat e mbledhura në program përdoren nga organizata për analizë të gjendjes fillestare dhe rrezultateve të arritura nga puna me secilin fëmijë që merr shërbime të ndryshme në organizatë.

OBJEKTIVI STRATEGJIK VI: QËNDRUESHMËRIA

ANAK vazhdon të siguroj qëndrueshmërinë e saj më së shumti nga kontributet minimale të prindërve dhe profesionalizmi i stafit të saj. Për më tepër, me anë të organizimit të

kampanjave të ndryshme të cilat përfshijnë krijimin e veprave të artit nga fëmijët me autizëm dhe shitjen e tyre, ANAK siguron të ardhura simbolike të cilat përdoren për funksionimin e organizatës dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët me autizëm dhe familjarët e tyre. Gjithashtu, ANAK ka mbështetjen e bizneseve private në Kosovë, të cilët vazhdimisht kontribuojnë financiarisht në organizatë me qëllim të ofrimit të shërbimeve esenciale për fëmijët me autizëm dhe familjarët e tyre.

ANAK vazhdimisht avokon dhe lobon për nevojën për mbështetje të personave me autizëm duke ofruar sistem të qëndrueshëm të ofrimit të shërbimeve sociale; mbështetje financiare dhe sociale për familjarët e fëmijëve me autizëm; krijimin e ambienteve adekuate të punës për fëmijë dhe të rritur me autizëm; si dhe ngritjen e kapaciteteve të edukatorëve dhe mësimeve të tjerë që ata të ofrojnë mbështetje profesionale fëmijëve me autizëm.

ANAK vazhdimisht aplikon tek donatorë të ndryshëm potencial për të mbështetur financiarisht zbatimin e programeve dhe projekteve të ndryshme të cilat do të kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes së personave me autizëm dhe integrimin e tyre në shoqëri si dhe ofrimin e mbështetjes së prindërve të fëmijëve me autizëm, të cilët gjithashtu janë faktorë kryesorë në përmirësimin e situatës së fëmijës së tyre si dhe integrimin e fëmijëve të tyre në shoqëri.

INFORMATA TË PËRGGJITHSHME RRETH AUTIZMIT

Autizmi është çrregullim neurobiologjik që veçohet me vështirësi në komunikim, ndërveprim shoqëror dhe sjellje të përsëritura dhe rreze të kufizuar interesash. Personat me autizëm që nga moshë e hershme e fëmijërisë ballafaqohen me sfida të ndërlidhura direkt me vëshirësitë e komunikimit, e cila mund të ketë si rrjedhojë zhvillimin e sjelljeve problematike nga pamundësia që fëmija të kuptojë perceptimin e të tjerëve. Situata rëndohet edhe më shumë kur fëmija arrinë moshën e adoleshencës, duke rritur kërkesat e tij/saj me sjelljet insistuese drejt realizimit të kërkesave.

Edhe pse sistemi arsimor në Kosovë e ka të obligueshme që të zbatoj ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës për inkuadrim të fëmijëve me autizëm brenda sistemit të rregullt edukativ, prindërit e fëmijëve me autizëm sistematikisht kanë sfida në procesin e inkuadrimin të fëmijëve të tyre, duke filluar me problemin praktik të mungesës së asistentëve individual në baza të rregullta. Në mungesë të kushteve ekonomike për të paguar asistentë, ndodh që prindërit të detyrohen të ndërpresin shkollimin e fëmijëve të tyre apo të asistojnë vet fëmijën e tyre në klasë. Ky është një reflektim i një zgjidhje simbolike të shtetit në raport me ligjin ku ofron të drejta, mirëpo ende nuk ka zgjidhje institucionale të qëndrueshme.

DISA NGA SFIDAT DHE VËSHTIRËSITË ME TË CILAT PËRBALLEN FËMIJËT ME AUTIZËM JANË:

A) VËSHTIRËSI NË NDËRVEPRIM SOCIAL

- Mungesë e interesimit për të zhvilluar miqësi me të tjerët;
- Mungesë e kontaktit me sy;
- Nuk tregojnë shprehje të gëzimit, suksesit apo arritjeve të tyre tek të tjerët;
- Kanë perceptim tjetër të kuptimit të gjendjes emocionale të të tjerëve si: gëzimin, dhimbjen, humorin, lojën etj.

B) VËSHTIRËSI NË KOMUNIKIM

- Në disa raste karakterizohen me vonesë në të folur ose fëmija ka thënë disa fjalë dhe rreth moshës 2-3 vjeçare fillon mos të i përsërit më;
- Mungesë e iniciativës për fillim të bisedës apo parashtrimin të pyetjeve;

- Ndonjëherë ka mungesë të komunikimit verbal duke përdorur fjalë me kuptim, apo vështirësi në komunikim jo verbal të nevojave të veta tek të tjerët, p.sh me gjuhë trupore;
- Mungesë e interesimit për pranim të kërkesave nga të tjerët;
- Përseritje fjalësh jashtë kontekstit, si fjalë nga një reklamë televizive.

C) SJELLJE PËRSËRITËSE DHE INTERESIM TË THEKSUAR NË GJËRA SPECIFIKE

- Lëvizje përsëritëse trupore si përplasje/lëkundje të duarve, rrotullim të objekteve, luajtje me gishta, rrotullim rreth vetes etj;
- Fiksime në shkronja, numra, pjesë objektësh, renditje të objekteve/ngjyarave etj;
- Përsëritje tingujsh të njëjtë;
- Fokusim të tepruar në detaje të gjërave përrreth duke anashkaluar tërësinë dhe funksionin e tyre;
- Nevojë të theksuar për një trajtshmëri dhe rutinë – ndalje në të njëjtin dyçan, të kaloj në të njëjtën rrugë, të dëgjoj të njëjtën pjesë të këngë/videos, etj.

Perceptimi për personat me autizëm


Është e evidente që personat me autizëm nuk dallojnë me karakteristika fizike nga personat me zhvillim tipik, ku shpesh herë kanë ndodhur keqkuptime nga rrethi kur janë ballafaquar me sjellje jo të zakonshme. Për shkak që spektri i autizmit ngërthen në vete lloje të ndryshme, elementet e të cilave variojnë shumë nga njëra tjetra, ka pasur edhe gjeneralizime sa i përket kapaciteteve apo sjelljeve për personat me autizëm. Për shembull, personat me autizëm që kanë funksion dhe intelegjencë të lartë janë përjashtuar nga gjithëpërfshirja në aktivitete për shkak që ata janë paragjykuar në bazë të sjelljeve jo tipike. Kurse rastet që kanë dendësi më të theksuar të elementeve të autizmit, të cilët nuk kanë zhvilluar aspak komunikim verbal, zakonisht kanë tendencë të viktimizohen nga rrethi.

Mundësitë e punësimit për personat me autizëm


Fuqizimi dhe ofrimi i mundësive për personat e rritur me autizëm, është tejet i nevojshëm në mënyrë që ata t'i shprehin aftësitë e tyre, qoftë ky një vend pune që lidhet me stereotipet e tyre p.sh renditje të librave në bibliotekë, në kompani të teknologjisë informative, në mirëmbajtje të natyrës, ku ata me përpikmëri do të mund t'i zhvillonin aktivitetet e tyre rutinore.

ANGAZHIMI I ANAK

Prej vitit 2012 e deri në vitin 2021, ANAK ka ofruar shërbime terapeutike profesionale dhe shërbime tjera për personat me autizëm dhe familjarët e tyre. Gjatë dhjetë (10) viteve, si përfitues direkt të ANAK janë regjistruar gjithsejt 310 persona me autizëm. Në grafikonët më poshtë, mund të gjeni ndarjen e përfituesve ndër vite dhe në gjini.




GRAFIKONI 1: NUMRI I FËMIJËVE ME AUTIZËM, PËRFITUES DIREKT I NDARË PËRGJATË DHJETË (10) VITEVE.




GRAFIKONI 2: NUMRI I FËMIJËVE ME AUTIZËM, PËRFITUES DIREKT PËRGJATË DHJETË (10) VITEVE TË NDARË NË GJINI

Rrezultatet konkrete


Gjatë dhjetë (10) viteve, nga 330 fëmijë me autizëm të cilët kanë përfituar nga shërbimet cilësore individuale të ofruara nga ANAK, 142 apo 46% e tyre kanë reduktuar sjelljet problematike dhe kanë arritur të kenë progres në zhvillimin e tyre verbal. Numri i fëmijëve me autizëm që kanë reduktuar sjelljet problematike ndër vite janë të përshkruara në grafikonët më poshtë.



GRAFIKONI 3: NUMRI I FËMIJËVE QË KANË PËRFITUAR NGA SHËRBIMET E ANAK DHE KANË REDUKTUAR SJELLJET PROBLEMATIKE




GRAFIKONI 4: NUMRI I FËMIJËVE QË KANË PËRFITUAR NGA SHËRBIMET E ANAK DHE ËSHTË REGJISTRUAR PROGRES VERBAL




GRAFIKONI 5: PROGRESI I FËMIJËVE NË FUSHËN E KOMUNIKIMIT NGA TË QENURIT JO VERBAL NË ZHVILLIM TË KOMUNIKIMIT

Gjatë dhjetë (10) viteve, nga 330 fëmijë me autizëm të cilët kanë përfituar nga shërbimet cilësore individuale të ofruara nga ANAK, 149 apo 48% e tyre janë integruar në kopshte dhe shkolla brenda sistemit të rregullt edukativ. Grafikoni më poshtë paraqet numrin e fëmijëve me autizëm që janë integruar në kopshte dhe shkolla i ndarë ndër vite.



GRAFIKONI 6: NUMRI I FËMIJËVE ME AUTIZËM QË JANË INTEGRUAR NË KOPSHTË DHE SHKOLLA

Gjatë dhjetë (10) viteve, ANAK ka bërë mbi 200 vlerësime të fëmijëve me autizëm në dhjetë fushat e zhvillimit të tyre, gjithashtu ka bërë mbi 400 rivlerësime dhe rivendosje të pikave të punës në planin individual të fëmijëve me autizëm.



GRAFIKONI 7: NUMRI I VLERËSIMEVE I NDARË NDËR VITE

Gjatë dhjetë (10) viteve, ANAK ka bërë 280 plane individuale të punës për 280 fëmijë me autizëm me fokus në përmisimin e sjelljeve problematike, si dhe ka bërë objektiva të qarta për secilën nga fushat e zhvillimit të komunikimit receptiv dhe ekspresiv, adaptimit social, shkathtësive të përgjithshme, duke përfshirë vetkontrollin e impulseve, në fushën motorike etj.

Gjatë dhjetë (10) viteve, ANAK ka arritur që të kryej mbi 600 trajnime me familjarë të ndryshëm të fëmijëve me autizëm apo fëmijëve me sfida tjera të ngjashme.

Gjatë dhjetë (10) viteve, ANAK ka trajnuar mbi 800 studentë të degës së psikologjisë, logopedisë, ergoterapisë dhe edukimit.

Gjatë dhjetë (10) viteve, ANAK ka trajnuar dhe konsultuar vullnetarisht rreth 89 asistentë të fëmijëve me autizëm për qasjet e përshtatshme dhe për intervenimet e nevojshme, varësisht nga sfidat individuale të fëmijëve gjatë procesit të integrit në sistemin e rregullt edukativ.

Gjatë dhjetë (10) viteve, ANAK ka arritur të ndikoj në edukimin direkt dhe ngritjen e kapaciteteve të mbi 1,300 profesionistëve të fushave të ndryshme të cilat ndërlihen me

autizmin.

Gjatë dhjetë (10) viteve, ANAK me ofrimin e trajnimeve bazike për autizmin, shenjat e hershme, shërbimet e duhura dhe procedurën e referimit, ka arritur 250 punëtorët shëndetësor, në dymbëdhjetë (12) Qendra të Mjekësisë Familjare nga shtatë (7) regjionet e Kosovës.

Gjatë dhjetë (10) viteve, ANAK ka arritur që të mbështes 52 kopshte nga rajone të ndryshme të Kosovës, duke përfshirë konsulta individuale për mësues, edukatorë, apo përmes asistentëve individual të fëmijëve gjatë procesit të integritimit.

Shërbimet dhe Aktivitetet Specifike të ANAK

INTERVENIMET TERAPEUTIKE

Shërbimet profesionale direkte terapeutike ditore për fëmijët me autizëm dhe familjarët e tyre të ofruar nga ANAK janë: vlerësim psikologjik; përpilim i detajuar i planit individual; trajnim i prindërve për zbatimin e objektivave dhe mënyrat specifike intervenuese; mbajtja e seancave terapeutike individuale; dhe konsulta sistematike të prindërve.



ANAK vazhdimisht kryen vlerësim të rasteve të reja dhe harton plane individuale të punës me fokus në përmirësimin e sjelljeve problematike si dhe përcakton objektiva të qarta për secilën nga fushat e zhvillimit të komunikimit receptiv dhe ekspresiv, adaptimit social, shkathtësive të përgjithshme, duke përfshirë vetkontrollin e impulseve, në fushën motorike etj.

PROCESI I EFEKTEVE TERAPEUTIKE

Zhvillimi i komunikimit tek fëmijët në ANAK

Intervenimi në fushën e të kuptuarit dhe të shprehurit gjatë zhvillimit të komunikimit tek fëmijët e caktuar ku vërehet kapaciteti i tyre verbal, bëhet me vigjilencë të theksuar nga terapistët që kushtëzojnë dhe stimulojnë fëmijët të shprehin me fjalë kërkesat e caktuara. Në këto raste specifike të sfidimit për zhvillim të komunikimit, dhe pas analizave individuale të atyre fëmijëve, terapistët në mënyrë strikte i bllokojnë fizikisht ato shpërbime të mundshme, deri në shprehjen verbale të fëmijës për arritjen e asaj kërkesë përmes fjalës. Kështu gradualisht, përderisa këta fëmijë arrijnë që me lehtësi të përsërisin edhe fjalë tjera dhe të ndryshme, përmbushin memorizimin e historive entuziaste përgjatë viteve në ANAK, të cilat shërbejnë si model inspirues drejt zhvillimit të mëtejshëm të fushave tjera zhvillimore për ata fëmijë, si dhe për rastet e ardhshme të cilët referohen për nevoja intervenuese.

Reduktimi i sjelljeve problematike të fëmijëve në ANAK

Përmirësimi i sjelljeve rezistente tek fëmijët me autizëm, poashtu edhe tek fëmijët me zhvillim neurotipik, e krijojnë një terren për zhvillimin e mëtejshëm të potencialeve të ndryshme dhe të vërteta të fëmijëve, të cilat shkathtësi kanë mundur të kenë qenë të pa eksploruara, e në anën tjetër kanë qenë të përforcuara nga rrethi, përmes dorëzimit të tyre karshi rezistencave të fëmijës. Serioziteti i lartë i terapistëve në ANAK, gjatë sfidimit të përpiktë kundrejt sjelljeve rezistente të fëmijëve, të cilët refuzojnë të marrin udhëzime nga të tjerët, rezistenca të cilat mund të zgjasin edhe me orë të tëra, është zhvilluar edhe përmes bllokimit të shpërblimeve të mundshme, në rastet kur fëmija vazhdon të rezistojë.

ANAK ka pasur raste të shpeshta kur fëmija i cili ka filluar shërbimin direkt terapeutik, ka qarë me orë të tëra. Pas analizave të sjelljes specifike, shqyrtimit të situatave dhe ndërlikohen e përforcimeve tek ai fëmijë, qartësohet nëse rastet e caktuara të të qajturit e fëmijës mund të ketë qenë si funksion për të arritur kërkesat e saj/tij, për të përfituar vëmendjen e të tjerëve, për t'u shmangur nga detyrat/udhëzimet e të tjerëve apo për arsye të brendshme sensorike. Pas intervenimit të duhur individual, fëmijët e ndalojnë pothuajse plotësisht të qajturit. Në raste të tilla, mënjanimi i të qajturit të vazhdueshëm të fëmijës, kontribuon në zhvillimin e harmonisë ndërpersonale tek

anëtarët tjerë të familjes apo shoqërisë së përfshirë, ndërsa në anën tjetër mundëson kushte stabile për fokusim profesional të prindërve dhe lehtësim të qasjes nga personeli i shkollës në mos stigmatizim nga bashkëmoshatarët e fëmijës në fjalë, e poashtu mund të krijoj mundësi të gjithpërfshirjes dhe pranimit më të lehtë në komunitet.

Metodat e qasjes së terapistëve karshi fëmijëve me autizëm ndahen edhe me prindërit e fëmijëve, të cilët rekomandohet të vazhdojnë qasjen e njejtë edhe në shtëpi dhe në ambiente të tjera. Trajtimi i fëmijëve me metoda të njejtë të qasjes është esenciale që fëmija të gjeneralizoj kuptimin e shkak-pasojës, ku ikja e përgjegjësive apo udhëzimeve i bllokton shpërblimet, përderisa i motivon ata në marrjen e atyre udhëzimeve në të ardhmen, pasi që pas bashkëpunimeve gjithmonë kanë përfituar shpërblime të dëshiruara.

Këto qasje në ANAK, ndër vite kanë mundësuar thyerjen e rezistencave në rreth 90% të rasteve, të cilët kanë përfituar nga shërbimi direkt ditor, duke i zbehur dukshëm sjelljet e dëmshme që pas intervenimeve ato sjellje mbesin me funksion 'jo-efikas'. Progresi i ndryshimeve rritet dhe përshpejtohet veçanërisht kur familjarët e fëmijëve vazhdojnë të njejtat qasje intervenuese në shtëpi apo në ambiente të tjera. Të gjitha rekomandimet e individualizuara dhe të detajuara jepen tek prindi/kujdestari për secilin fëmijë,

pasi terapistët e ANAK i kanë analizuar dhe i kanë vlerësuar paraprakisht përdorimin e atyre teknikave specifike për sjellje të veçanta.

INTEGRIMI I FËMIJËVE ME AUTIZËM NË SISTEMIN EDUKATIV

ANAK sistematikisht ka luajtur rolin e urës lidhëse me kopshtet dhe shkollat, duke punuar paraprakisht në reduktimin e sjelljeve rezistente të fëmijëve përmes intervenimit individual, duke i gjeneralizuar ato sjellje të adaptuara në vende të ndryshme dhe me njerëz të ndryshëm, që pastaj ata të jenë më bashkëpunues dhe të marrin instruksione në ambiente tjera. Mirëpo, gjatë procesit praktik të integrimit në sistemin e edukimit, ANAK vazhdimisht ka hasur në sfidat e një sistemi të paorganizuar në shërbimet e duhura sociale në Kosovë.

Për të mbështetur në mënyrë efektive procesin e integrimit të fëmijëve me autizëm në kopshte dhe shkolla, ANAK ka kontribuar në rritjen e burimeve njerëzore, kështu duke ndikuar në rritjen e numrit të konsultave dhe rekomandimeve specifike të individualizuara për secilin fëmijë. ANAK vazhdimisht ka ofruar mbështetje asistentëve individual dhe edukatorëve me sygjerime specifike për secilin fëmijë, si dhe ka mbështetur prindërit e tyre përgjatë sfidave të ndryshme gjatë procesit të integrimit të

fëmijëve të tyre për intervenimet e nevojshme varësisht nga sfidat individuale të fëmijëve gjatë procesit të integimit në sistemin e rregullt edukativ. Për më shumë, kur asistentët kanë raportuar për sjellje sfiduese për fëmijën e caktuar, terapistët e ANAK krahas objektivave të paracaktura nga plani individual i atij fëmije, e kanë pasur fokus zhvendosjen e intervenimit për atë sjellje, duke i dhënë asistentëve rekomandime konkrete intervenuese.

Në anën tjetër ANAK ka avokuar sistematikisht që të drejtat e fëmijëve me autizëm në sistemin e edukimit të realizohen dhe të mbështeten.

AKTIVITETE REKREATIVE DHE EDUKATIVE

Adaptimi i mësimin në ambientet e tjera

Në ANAK, përgjatë seancave terapeutike, pjesë e terapisë ka qenë edhe adaptimi i mësimin në ambientet e tjera. Një prej vendeve të preferuara për mësim ka qenë Parku i Qytetit, oborri i organizatës dhe pjesëmarrja në lojërat olimpike të organizuara për fëmijë. Në natyrë fëmijët kanë mësuar punën individuale, grupe, ecjen paralele, argëtimin në këndin e lojërave, pritjen e radhës dhe njohjen e rregullave sociale për mbrojtjen e ambientit.

Në kuadër të aktiviteteve jashtë seancave terapeutike, fëmijët e organizatës kanë



marrë pjesë edhe në vizita të ndryshme si ‘Utalaya Foundation’ ku me organizimet eksploruese në natyrë dhe te pylli i arinjëve, shkathtësitë e mësuara gjatë terapisë janë gjeneralizuar në ambientet e bukura të natyrës.

Tutje, në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës është organizuar aktiviteti ‘Biblioteka në Shesh’, për t’u mundësuar fëmijëve me autizëm që kanë dhunti në renditje strikte të gjërave/librave të prezantojnë shkathtësitë e tyre.



Kjo praktikë shërben si përgatitje e terrenit, drejt punësimit të tyre të mundshëm, si bibliotekarë të ardhshëm.



Disa fëmijë të ANAK kanë qenë pjesmarrës në aktivitetet e “Festivalit Olimpik Tokyo 2020”, të organizuar nga Kosovo Olympic Committee në Prishtinë.




PJESËMARRJA NË EKSPOZITA

Ekspozita “Embrace Me Kosovo”, e realizuar nga fotografja holandeze Karin Brongers, ka pasur fokus fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara për një shoqëri gjithpërfshirëse dhe të barabartë.



Ekspozita “Komunikimi përmes Artit”, e organizuar nga HB atelier ka kontribuar në formë financiare duke dhuruar të hollat e mbledhura nga shitja e pikturave të paraqitura në këtë ekspozitë.



“Ngritu, Vallëzo, Ec, Bërtit ose Këndo!”

Në vitin 2019, ANAK dhe CINEPLEX kanë organizuar ditën e filmit për fëmijët e spektrit të autizmit dhe prindërit e tyre, në kuadër të muajit të vetëdijesimit mbi autizmin.

Filmi është shfaqur në një ambient miqësor sensorik. Kjo nënkupton që gjatë shfaqjes së filmit, ambienti ka qenë plotësisht i përshtatshëm në zë dhe drita, për të larguar të gjithë stimujt e mundshëm, ndërsa fëmijët kanë qenë të lirë të lëvizin, të hanë dhe të pijnë, të bërtasin, të këndojnë dhe të largohen nga salla sa herë që kanë dashur. Ky aktivitet ishte mundësi shumë e mirë e mbështetjes sociale dhe argëtimit, por njëkohësisht ka ndikuar që të shkojmë një hap më tutje në zhvillimin e shkathtësive sociale të fëmijëve dhe në mbështetjen e idesë se edhe fëmijët e spektrit të autizmit mund ta shijojnë një ditë të këndshme në kinema.

Të tilla nisma kanë ndikim në jetën e fëmijëve dhe familjeve të tyre dhe duhet të jenë pjesë e kinemave dhe platformave tjera të artit e kulturës, duke pasur parasysh krijimin e një ambienti pranues dhe të përshtatshëm për personat e spektrit të autizmit dhe familjet e tyre.



TRAJNIME DHE DISKUTIME

Diskutimet

ANAK në vazhdimësi ka zhvilluar mbi 150 diskutime me profesionistë të fushave të cilat ndërlidhen me natyrën e autizmit, ka mbajtur punëtori me institucione relevenate dhe ka qenë pjesmarrëse në konferenca dhe trajnime profesionale, me qëllim të ngritjes së vetëdijës mbi autizmin, matjes së nevojave eventuale dhe definimit sa më praktik të rekomandimeve drejt zgjidhjeve strategjike insitucionale. Disa nga aktivitetet e organizuara nga ANAK ndër vite janë:

- **Tryezë diskutimi “Autizmi - Sfidat e integritit në komunitet”** i cili ka qenë i fokusuar në vënien në pah të vështirësive praktike që personat me autizëm dhe ata me nevoja të veçanta hasin gjatë gjithëpërfshirjes.


Trajnimet

- **Trajnimet individuale të familjarëve të fëmijëve:**

Duke bërë vazhdimisht konsulta me prindër dhe përmes pjesëmarrjes së prindërve gjatë seancave terapeutike, ANAK ka kontribuar edhe në përkrahjen emocionale të prindërve të fëmijëve me autizëm, si dhe i ka mbështetur ata në përdorimin e metodave të njëjta të cilat janë analizuar si të përshtatshme specifikisht për fëmijët e tyre në shtëpi.

- **Trajnimet e Studentëve**

ANAK që nga themelimi i saj ka bashkëpunim të ngushtë me Departamentin



e Psikologjisë së Universitetit të Prishtinës dhe ka vazhduar të ofroj mbajtjen e mijëra orëve praktike për studentët e këtij departamenti.

- **Trajnimet e punëtorëve shëndetësor**

Nismat e ANAK për të bashkëpunuar me institucionet përkatëse në baza sistematike, ka ndikuar në funksionalizimin më të mirë të zinxhirit të referencës së rasteve gjatë vitit 2021. Për të rritur identifikimin sa më të hershëm të rasteve të dyshuara për autizëm, ANAK ka mbajtur trajnimet bazike për: autizmin, shenjat e hershme, shërbimet e duhura dhe procedurën e referimit. Me organizimin e këtyre trajnimeve, ka pasur ndikim të dukshëm në rritjen e ndërgjegjësimit për zbulimin e hershëm të fëmijëve me autizëm, duke rezultuar në rritjen e numrit të referimeve në ANAK nga qendrat e ndryshme familjare të Kosovës. Madje, disa punëtorë shëndetësorë kanë referuar raste në ANAK, pasi kanë shqyrtuar përsëri materialin elektronik të trajnimit kur kanë hasur raste të dyshuara për autizëm gjatë punës së tyre të përditshme.

- **Trajnimet me punëtorët social**

ANAK ka mbajtur trajnime me Qendra për Punë Sociale të shtatë regjioneve të Kosovës, duke përfshirë punëtorë social nga: Prishtina, Gjlani, Fushë Kosova, Podujeva, Shtimja, Ferizaji, Lipjani, Drenasi, Prizreni, Gjakova, Suhareka, Mamusha, Dragashi, Istogu, Klina dhe Peja. Me anë të organizimit të këtyre trajnimeve, ANAK ka arritur të kontribuoj në rritjen e vetëdijës së punëtorëve social mbi autizmin, sfidat e



e autizmit në komunitet, rolin e punëtorëve social gjatë ballafaqimit me autizmin, qasjen e punëtorëve social në punën me familjet që kanë fëmijë apo të rritur me autizëm në familje, zgjidhjet e ndryshme në raport me këtë çështje. Tutje, ANAK ka arritur të informojë punëtorët social me metodat e ballafaqimit dhe ka dhënë rekomandime të qasjes në raport me sjelljet problematike të fëmijëve, dhe gjithashtu është bërë vetëdijësimi për referimet e rasteve me autizëm dhe shërbimet e nevojshme.

- **Trajnimet mbi sfidat e adoleshencës tek fëmijët me autizëm**

Me anë të organizimit të këtij trajnimi, ANAK ka arritur të ngrisë vetëdijen e 70 pjesëmarrësve të cilët ishin prindër të fëmijëve me autizëm, psikologë, logopedë, asistentë të fëmijëve me autizëm në kopshte dhe shkolla, rreth sfidave të adoleshencës tek personat me autizëm, vështirësitë e gjumit dhe të ushqyerit që personat me autizëm kalojnë në fëmijëri, si dhe metodat praktike intervenuese për kuptimin e tejkalimin e këtyre situatave sfiduese.

- **Trajnime për personel dhe prindër**

Trajnimi me temën “Seksualiteti dhe Marrëdhëniet tek Personat me Autizëm” dhe Ndikimi i Stresit dhe Ankthit në Sjelljet Problematike tek Fëmijët me Autizëm ka kontribuar në ngritjen e kapaciteteve të stafti të ANAK dhe prindërve të fëmijëve të cilët marrin shërbime nga ANAK në lidhje me

ballafaqimin e sfidave të kësaj natyre dhe identifikimin e metodave dhe hapave të mundshëm intervenues me ide praktike të cilat janë prezantuar me anë të fotografive.



• **Trajnimet e Edukimit Special**

Stafi profesional i ANAK është trajnuar nga Trajnimet e Edukimit Special në partneritet me TIKa. Fushat e trajnimit kanë qenë: edukimi i personave me nevoja të veçanta: zhvillimi i aftësive bazë të të nxënit; përcaktimi i sjelljes së synuar dhe dizajnimi i arsimit; zhvillimi i aftësive gjuhësore dhe të të folurit te njerëzit me rënie; sindromi dhe autizmi; problemet e sjelljes dhe metodat e tejkalimit; tabela e veprimtarive; pavarësia, zgjedhja dhe zhvillimi i shoqërisë; ndërveprimi; zhvillimi dhe edukimi seksual; dhe teoria e mendjes.



• **Praktika dhe Vullnetarizimi**

ANAK në mënyrë të vazhdueshme ka ofruar rreth 10 mijë orë praktike pune për studentët e degëve të Psikologjisë, Logopedisë, Ergoterapisë dhe Edukimit. Në bazë të praktikës janë identifikuar personat tek të cilët janë vërejtur kapacitete si: të kuptuarit e thelbit dhe logjikës së teknikave të terapisë së sjelljes, ka reflektuar durimin dhe vullnetarizimin e pakusht, ka shfaqur kureshtje me pyetjet e tyre specifike etj. dhe janë bërë pjesë e ANAK për një periudhë të caktuar.

Në vitin e fundit, ANAK ka krijuar një sistem të ri kuantitativ të mbajtjes së orëve praktike me numër të limituar të praktikantëve. Metoda e trajnimeve online është inicuar fillimisht si adaptim i masave mbrojtëse nga Covid-19 dhe zhvendosjes së orëve praktike të studentëve me module të ndara të trajnimeve me këto tematika: “Autizmi dhe trajtimi”, “Metodat intervenuese”, “Analiza e Aplikuar e Sjelljes”, “Puna vullnetare në ANAK”,

“Vlerësimi i fëmijëve me autizëm”, “Shkrimi i planit individual”, “Futja e të dhënave në sistemin E-data”. Pas çdo ligjerate nga mentorët, praktikantët kanë pasur detyra në bazë të temës së trajnuar, pastaj janë kontrolluar dhe është dhënë feedback për përmirësime ose sygjerime. Kjo për arsyeje që studentët të përfitojnë shkathtësi profesionale në të shkruar dhe raportim, para se të fillohet obzervimi direkt i rasteve. Për obzervimet e rasteve, praktikantët paraqesin edhe raporte të rasteve (vetëm për përdorim të brendshëm dhe për çështje monitoruese profesionale nga ANAK). Këta persona të përfshirë kanë kontribuar edhe në aktivitete tjera të organizuara nga ANAK.

- **Kampanjat e muajit të vetëdijësimit për autizëm**

Duke pasur parasysh sfidat e vazhdueshme me të cilat përballet ANAK, shpeshherë perceptimi i gabuar që familjet kanë për personat me autizëm, historikisht e ka vështirësuar dhe vazhdon të bllokojë zhvillimin e ofrimin e shërbimeve sociale për personat me autizëm dhe familjet e tyre. Prandaj ANAK që nga themelimi i saj, ka zhvilluar kampanja vetëdijësuese të cilat kanë pasur synim ndarjen e njohurive për autizmin, nevojat e personave me autizëm dhe familjarët e tyre dhe shërbimet e nevojshme që duhet të u ofrohen personave me autizëm, duke vënë në pah çdo herë aftësitë e tyre të jashtëzakonshme dhe potencialin e tyre për të u integruar në shoqëri.




Kampanjat e organizuara nga ANAK nga viti 2012 deri në vitin 2021 janë:

- Kampanja “Për njëri tjetrin” ka vazhduar avokimin përmes artit e jo viktimizimit, duke i promovuar aftësitë autentike të fëmijëve me autizëm, drejt shërbimeve esenciale.



- Kampanja “Për njëri tjetrin”, e cila ka promovuar talentet e fëmijëve me autizëm përmes krijimit dhe shitjes së pikturave, ku shuma e mbledhur ka mundësuar ofrimin e shërbimeve esenciale pa pagesë për fëmijët me autizëm, të cilët kanë gjendje më të rënduar socio-ekonomike.



- Kampanja “Kontribuo për autizëm”, ka shërbyer si thirrje që personat me autizëm të trajtohen drejtësisht në shoqërinë kosovare, përkritazi me shkathtësitë, nevojat dhe potencialet e tyre. Ky vizion, në vazhdimësi ka kaluar trajtimin e personave me autizëm në baza të barazisë, i cili në vete konkretisht ka qenë diskriminues kur kemi parasysh natyrën unike të personave me autizëm, shkathtësitë, nevojat dhe potencialet e tyre.
- Kampanjën “Për njëri tjetrin”, ka kontribuar në rritjen e vetëdijësimit të kompanive, individëve e organizatave mbi shërbimet e nevojshme për fëmijët me autizëm dhe ka arritur të mbledhë fonde për ti mundësuar shërbimet esenciale fëmijëve me kushte të vështira ekonomike, specifikisht ofrimin e seancave individuale për fëmijët me autizëm, të cilët kanë qenë më të prekurit nga Covid-19.

- Për ngritje të vetëdijësimit për autizmin ANAK ka organizuar aktivitetin "Çiklizëm për Autizëm" ku përmes sportit dhe në një kënd të krijuar miqësor për autizmin (Autism friendly), shumë çiklistë, fëmijë, prindër, vullnetarë, i janë bashkuar rrugëtimit në parkun e Gërmisë, si solidarizim dhe mbështetje për të drejtat e personave me autizëm.



- ANAK dhe Qendra për Hulumtime Psiko-Sociale dhe Mjekësore (QHPSM), në kuadër të aktiviteteve për ngritjen e vetëdijësimit mbi autizmin, kanë mbajtur ngjarjen "Evidence Based Future V: Autizmi" (E ardhmja e mbështetur në evidencë). Qëllimi i kësaj ngjarje, ishte prezantimi i hulumtimeve shkencore, që ofrojnë analizën e nevojave dhe që mund të shërbejnë si themel për ndërtimin e intervenimeve efikase, për sferën e autizmit dhe një tryezë diskutimi mbi këtë temë me disa profesionistë dhe politikëbërës vendor.



- Si mekanizma për ndërgjegjësim të mëtejshëm të edukatorëve dhe personave tjerë të cilët kanë qenë të përfshirë direkt me fëmijët me autizëm, ANAK ka zhvilluar konsulta, trajnime dhe ligjërata falas lidhur me intervenime praktike bazuar në parimet e analizës së sjelljes dhe sjelljes verbale.
- Pikturat abstrakte të fëmijëve nga ANAK kanë marrë pjesë edhe në ekspozitën "Speak Up Kosovo" në ASK (American School of Kosova).
- Për nder të Ditës Botërore të Fëmijëve, në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, ANAK ka organizuar "Art në Autizëm" si ekspozita e parë në Kosovë, me punimet e punara direkt

nga fëmijët me autizëm e të cilët kanë qenë përfitues të shërbimit direkt të ANAK. Pasi komunikimi është një nga tri vështirësitë themelore për personat me autizëm, përmes Artit ata kanë shprehur veten e tyre duke zëvendësuar komunikimin verbal me gjuhën e ngjyrave. Gjallëria dhe poziviteti që u reflektuan në piktura paraqiti më së miri botën shumëngjyrëshe të fëmijëve me autizëm. Punimet e fëmijëve u shoqëruan me përshkrime të karakteristikave të fëmijëve, gjë që i shtoi më shumë kuptim dhe kureshtje lexuesve për të analizuar më shumë pikturën dhe për të kuptuar botën e tyre.



- Përveç traditës së stolisjes së pemës me kuota të ndryshme, ANAK ka zhvilluar aktivitete me ligjerata për studentë të fushave përkatëse, e procesi i ndërgjegjësimit gjatë këtij viti ka reflektuar në më shumë interesim të shoqërisë për autizmin dhe nevojat konkrete të tyre.
- Organizimi i “Ekspozitës Artistike të Fëmijëve me Autizëm”, e cila ka pasur për qëllim promovimin e shkathtësive artistike të fëmijëve me autizëm dhe njëkohësisht avokimin tek institucionet relevante në Kosovë, për të inspiruar zhvillim të mëtejshëm të këtyre shkathtësive përmes ngritjes së shërbimeve profesionale të domosdoshme për autizëm.
- Përmes kampanjës “Kam të drejtë të jem ndryshe”, ANAK organizoi aktivitete në të gjitha regjionet e Kosovës përmes shpërndarjes së kuotave për autizëm dhe stolive të tjera me thënie mbi autizmin, duke prezantuar karakteristika individuale të personave me autizëm.
- Duke pasur parasysh prirjen shoqërore të të vënit fokus tek vështirësitë më shumë sesa tek shkathtësitë dhe potencialet, ANAK në vitin 2015 për nder të muajit Prill (muaj i vetëdijësimit mbi autizmin) organizoi kampanjën vetëdijësuese “Autizmi dhe Talentet”. Gjatë kësaj kampanje përveç traditës tanimë të krijuar – stolisja e nga një peme me kuota mbi autizmin në secilin regjion të Kosovës, ftoi në një koncert gjenium e muzikës i cili është njëherit me autizëm dhe i verbër, Zt. Derek Paravicini.

Vizita e Derek Paravicinit bëri një kthesë të madhe në perceptimin e personave me autizëm në përgjithësi, por në veçanti ka shtuar kurajon dhe gatishmërinë e prindërve për të kuptuar dhe pranuar edhe më shumë se kurrë vështirësitë dhe sfidat e autizmit, dhe të njëjtën kohë gatishmërinë për të vënë në fokus shkathtësitë dhe potencialet e fëmijëve të tyre.



- Organizimi i kampanjës vetëdijësuese në shtatë (7) regjione të Kosovës, ku përmes vullnetarizmit të studentëve të Psikologjisë mundësoi stolisjen e nga një peme në secilin region me kuota mbi autizmin dhe shkathtësitë unike të personave me autizëm.



- Nën mbështetjen e Rona Nishliut, Genc Salihut, Gipsy Groove dhe Hamam Jazz Bar, është mbajtur koncerti për nder të ditës ndërkombëtare të autizmit i cili kishte për qëllim vetëdijësimin mbi autizmin dhe ngritjen e fondeve për organizatën përmes pikturave të punuara nga vetë stafi i ANAK.
- Përmes DAM Fest me moton “Autizmi dhe Muzika” ANAK ka shprëndarë tek audiencia e DAM Fest në formë të shkruar informata mbi autizmin dhe aftësitë e jashtëzakonshme të tyre në muzikë.
- Panel disuktimi në departamentin e Psikologjisë mbi rëndësinë e fillimit të shërbimeve të nevojshme.

BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL

Departamenti i Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës

ANAK, që nga themelimi i saj, ka pasur bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Psikologjisë së Universitetit të Prishtinës. Si pjesë e bashkëpunimit, ANAK ofron mundësinë për studentët e Departamentit të Psikologjisë, të bëjnë orë praktike me qëllim të avancimit të tyre rreth trajtimit të personave me autizëm duke marrë pjesë gjatë seancave terapeutike.



Instituti i Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

ANAK ka bashkëpunim të mirëfilltë me Institutin e Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me të cilët planifikon të bëjë organizimin e procesit të përgatitjes së përpilimit të moduleve të strukturuar të trajnimeve për nivelin Master të Psikologëve Shkollor. Ky proces, përveç përpilimit të materialeve, do të rezultojë edhe në publikimin e raporteve dhe hulumtimeve me rezultate të ndryshme profesionale nga analizimi i variabëlve të ndryshme përbrenda të dhënave sistematike, të cilat regjistrohen në programin shkencor E-Data në ANAK.

Qendrat për Punë Sociale të Kosovës dhe Departamenti i Punës Sociale në Universitetin e Prishtinës

ANAK gjatë punës dhjetë (10) vjeçare, ka kontribuar në ngritjen e kapaciteteve të punëtorëve social të cilët punojnë drejtpërdrejt me familjet e fëmijëve me autizëm. Gjatë punës së ANAK ndër vite, është vërejtur që punëtorët social hasin në vështirësi të trajtimit të personave me autizëm për shkak të mungesës së psikologëve brenda qendrave për punë sociale dhe kushteve të tjera elementare. Gjithashtu, mos ndarja e kategorive

për menaxhim të rasteve e ndërlikon sistemin e referimeve dhe njohurive. Numri i madh i rasteve që kanë nevojë për trajtim të cilët janë nën menaxhim të punëtorëve social pamundëson zgjidhjet praktike të referimeve dhe monitorimin e vështirësive që hasin familjet gjatë integritit të fëmijëve të tyre.

Në anën tjetër bashkëpunimi me Departamentin e Punës Sociale, Universiteti i Prishtinës kontribuon në zhvillimin e fushës së shërbimeve sociale, duke trajnuar studentët e kësaj fushe, drejt zhvillimit sa më efikas të shërbimeve sociale në të ardhmen.


Drejtoria e Mirëqenies Sociale, Komuna e Prishtinës

Një ndikim të fortë për funksionimin e duhur të shërbimit të ANAK, ka luajtur bashkëpunimi i ngushtë me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale të Komunës së Prishtinës. Roli i fuqishëm ka qenë në mbështetjen financiare për ANAK për disa vite me radhë, ku janë mbuluar shpenzimet elementare të zyrës. Po ashtu, së bashku kemi shqyruar përcaktimin e hapave për subvencionimin e shërbimeve për personat me autizëm dhe familjet e tyre në të ardhmen, duke filluar nga ofrimi falas i “Pakos Esenciale” për çdo fëmijë me autizëm në Kosovë dhe familjet e tyre.

INICIATIVA INDIVIDUALE PËR MBËSHTETJE TË ANAK

Mini-Maratona “Vrapo për autizëm”

Në vitin 2015 me iniciativën dhe mbështetjen e plotë nga Afërdita Paqarada, u organizua Mini-maratona me moton “Vrapo për Autizëm”, e cila jo vetëm që i dha një shtyrje përpara shërbimeve ekzistuese në ANAK por edhe ndikoi edhe më shumë vetëdijësimimin dhe perceptimin e shoqërisë për autizmin duke influencuar edhe gatishmërinë për të mbështetur shërbimet e nevojshme.



Në vitin 2019 është mbajtur Mini Maratona 5 km “Vrapo edhe ti” e Organizuar nga Afërdia Paqarada dhe Diellza Kolgeci, shuma e të cilave iu është dedikuar shërbimeve emergjente për fëmijët me autizëm.

Përkrahja nga Sunny Hill Foundation dhe Dua Lipa

Në Gusht të vitit 2018, këngëtarja me famë botërore, Dua Lipa, përmes fondacionit “Sunny Hill”, ka kontribuar në ANAK me shumën prej 5,000 Euro të cilat e kanë lehtësuar dukshëm gjendjen emergjente me anë të blerjes së mjeteve kualitative pedagogjike dhe rekreative, me librarinë e vogël për fëmijë brenda qendrës, si dhe ka mbuluar vështirësitë e paparashikueshme financiare në rastet kur kontributi i prindërve për shërbimet e fëmijëve të tyre ka qenë i pamundur.



Përkrahja nga Sunny Hill Foundation dhe Dua Lipa

Në Gusht të vitit 2018, këngëtarja me famë botërore, Dua Lipa, përmes fondacionit “Sunny Hill”, ka kontribuar në ANAK me shumën prej 5,000 Euro të cilat e kanë lehtësuar dukshëm gjendjen emergjente në qendrën tonë me mjete kualitative pedagogjike dhe rekreative, me librarinë e vogël për fëmijë brenda qendrës, si dhe ka mbuluar vështirësitë e paparashikueshme financiare në rastet kur kontributi i prindërve për shërbimet e fëmijëve të tyre ka qenë i pamundur.

SFIDAT NDËR VITE

Disa nga sfidat me të cilat është përballuar ANAK gjatë dhjetë (10) viteve punë janë:

- Mungesa e mbështetjes financiare afatgjate e cila garanton qëndrueshmëri për organizatën; rrjedhimisht, ofrimin e shërbimeve cilësore terapeutike për fëmijët me autizëm dhe familjarët e tyre;
- Mungesa e mbështetjes financiare nga donatorë të ndryshëm për tejkalimin e sfidave me të cilat organizata është përballur, sidomos rreth krijimit të infrastrukturës dhe paisjeve adekuate të nevojshme për trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve për personat me autizëm;
- Mungesa e mjeteve kualitative pedagogjike dhe rekreative;
- Mungesa e mbështetjes institucionale në krijimin e infrastrukturës adekuate për trajtimin dhe mbështetjen e fëmijëve me autizëm dhe familjarët e tyre;
- Mungesa e mbështetjes institucionale në ngritjen e kapaciteteve të mësimit dhe edukatorëve rreth autizmit dhe metodave adekuate efektive të trajtimit të personave me autizëm;
- Sistem i pa organizuar në shërbimet e duhura sociale;
- Mungesa e kushteve të trajtimit të adoleshentëve me autizëm;
- Mungesa e gatishmërisë së institucioneve publike dhe private rreth integritit të personave me autizëm specifkisht, krijimin e vendeve të punës.

ANAK NË VITET E ARDHSHME

ANAK synon për të informuar institucionet dhe shoqërinë në përgjithësi mbi origjinalitetin e personave me autizëm, talentet e tyre unike, nevojat për shërbime dinjitoze, dhe për të avokuar mbi pabarazinë e të drejtave të tyre, karshi një mos funksionimi të duhur politik, ekonomik e shoqëror në Kosovë. Hapat avokues të ANAK fokusohen në shqyrtimet dhe përmbushjet e fushave të mëposhtme:

LIGJI GJITHPËRFSHIRËS

Pjesë e programit avokues të ANAK është edhe angazhimi rreth përpilimit të “Projektligjit dhe Raportit final për Projektligjin për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet dhe Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuar”, i cili do të kontribuojë edhe më shumë në një stabilitet financiar nga burimet shtetërore për personat me autizëm e veçanërisht për familjet e tyre. Ligji i ri për shërbime sociale dhe familjare, ka për qëllim adresimin e nevojave për ekipë multidisiplinare nëpër institucione relevante edukative, e veçanërisht për sistemimin e psikologëve në qendrat për punë sociale.

OFRIMI I PAKOS ESENCIALE FALAS

ANAK është duke punuar fuqishëm që për të gjithë fëmijët me sfida socio-ekonomike në Kosovë, të jetëson ofrimin e shërbimeve falas me “PAKO ESENCIALE”, e cila përfshinë: vlerësimin individual (për secilin fëmijë me autizëm apo të dyshuar me autizëm), shkrimin e planeve individuale të punës, trajnimin e secilës familje në mënyrë specifike për procedurat e ndërhyrjes, si dhe seanca të rregullta javore terapeutike me fëmijën, të shoqëruara me konsulta të rregullta të familjarëve të tyre. Arritja e këtij modeli social, synohet të bëhet përmes subvencionimit të shërbimeve nga institucionet publike si dhe nga sponsorizimi stabil dhe afatgjatë i kompanive, bankave apo bizneseve të ndryshme. Me funksionimin stabil të pakos esenciale, ANAK do të vazhdoj avokimin duke prezantuar këtë sistem tek Qeveria e Kosovës dhe institucionet përgjegjëse dhe do të krijoj plane dhe strategji stabile afatgjate, drejt mundësisht të shërbimit direkt për secilin fëmijë në Kosovë pa asnjë diskriminim.

QËNDRIM DITOR PËR PERSONAT ME AUTIZËM MBI 18 VJEÇ

ANAK do të avokoj për krijimin e një qëndrimi ditor për personat me autizëm që janë të moshës madhore, mbi 18 vjeç. Qëndrimi ditor propozohet të ofroj aktivitete që stimulojnë potencialin e tyre drejt pavarësisht dhe angazhimit në gjëra praktike, të cilat mund të zhvillojnë mundësi për punësim varësisht nga aftësitë apo sjelljet e tyre stereotipet/të përsëritshme.

MUNDËSIMI I ASISTENTËVE INDIVIDUAL PA PAGESË

ANAK, me mbështetje financiare nga donatorë të ndryshëm, planifikon të mbulojë pagesën e asistentëve individual të fëmijëve me autizëm që janë në proces të integritit në kopshte dhe shkolla dhe që kanë sfida të natyrës socio-ekonomike.

MONITORIM SISTEMATIK I ASISTENTËVE MBËSHTETËS

ANAK do të punoj rreth krijimit të një komisioni profesional dhe etik, i cili do të ketë rol për të mbikëqyrur asistentët që punojnë me fëmijët brenda sistemit të rregullt edukativo-arsimor në Kosovë, dhe për të rishikuar progreset/sfidat e fëmijëve me autizëm në gjithë procesin.

SIGURIMI I EKIPËS MULTIDISCIPLINARE GJATË PROCESIT TË DIAGNOZAVE PËRMES SIGURIMEVE SHËNDËTËSORE

Bazuar në sfidat e theksuara të prindërve në rast të dyshimeve të familjarëve lidhur me zhvillimin e fëmijëve të tyre, është e nevojshme që të mundësohet krijimi i një ekipe diagnozuese i përbërë nga psikiatër i fëmijëve dhe pediatër në kopshte dhe shkolla.

NGRITJA E VETËDIJES DHE KOMPANJAT AVOKUESE

ANAK vazhdimisht ka avokuar dhe avokon që Qendrat për Punë Sociale që të kenë të ndara kategoritë që do të menaxhojnë rastet që paraqiten nga qytetarët e Kosovës, përfshirë edhe personat me autizëm. Kjo është e domosdoshme për sistemin e njohurive dhe referimeve adekuate dhe specifike si dhe për qasje të duhur për shërbime sociale dhe për zgjidhjen praktike të vështirësive që familjet e personave me autizëm hasin.

ZHVILLIMI I METODOLOGJIVE DHE MODULEVE PROFESIONALE

ANAK planifikon të fokusohet në zhvillimin e metodologjive dhe moduleve profesionale të avancuara, të cilat njëkohësisht do të përmbushin mungesën serioze të literaturës dhe prezantimeve profesionale interveuese në gjuhën shqipe.

ANAK ka për qëllim të punoj drejt integritit konkret të fëmijëve me autizëm në sistemin e rregullt edukativ përmes studentëve të psikologjisë dhe edukimit, me ç'rast obligimin e kryerjes së praktikës ta zhvendosin zyrtarisht në obligim të përkushtuar dhe zyrtar duke i asistuar direkt fëmijët me autizëm. Kjo objektivë do të mundësojë një ndryshim konkret nëpërmes: integritit individual të fëmijës, ku prindi nuk do të paguante asistent për fëmijën; studentët e përkushtuar do të krijonin përvojë të njohur/zyrtare pune; dhe Komuna do të realizonte obligimin e saj për shkollim cilësor dhe gjithpërfshirje.

KRIJIMI I MUNDËSIVE PËR PUNËSIM

ANAK do të krijojë mundësi për personat me autizëm të përfitojnë nga ofrimi i programeve për zhvillim të zanateve, shprehjeve artistike apo për zhvillim të kapaciteteve të ndryshme të tyre. Kjo mënyrë krijon mundësinë për përgatitjen e personave me autizëm të jenë konkurent në tregun e punës. Gjithashtu, ANAK është në proces të rritjes së vetëdijësimit të kompanive dhe insitucioneve në Kosovë, lidhur me aftësitë e rralla që personat me autizëm mund t'i kenë dhe mundësitë për punësimin e tyre. Aktualisht është identifikuar Biblioteka Kombëtare e Kosovës dhe një kompani që merret kryesisht me zhvillimin e teknologjisë informative.

Këtë objektivë ANAK e ka synim që deri në vitin 2023 t'a arrijë duke bashkëpunuar me institucione të vendeve të zhvilluara dhe me institucione/kompani lokale, biznese të ndryshme etj.

MBËSHTETJE ONLINE PA PAGESË

ANAK ka synim që deri në vitin 2023, të krijoj një degëzim të një Linje Telefonike të Ndihmës për familjet, shkollat, kopshtet, dhe komunitetin e gjerë, të cilët do të ketë mundësinë për qasje në informata bazike për autizmin, shërbimet e nevojshme apo informata tjera të ndërlidhura me të drejtat e personave me autizëm.

DONATORËT AKTUAL TË ANAK

Projektet ekzistuese

Drejtoria e Mirëqenies Sociale, Komuna e Prishtinës e cila për vitet 2019 - 2022 është duke e mbështetur hapësirën e ANAK së bashku me harxhimet bazike komunale, hapësirë e cila shfrytëzohet për ofrimin e shërbimeve direkte terapeutike për fëmijët me autizëm, shërbimet psiko-sociale dhe organizimin e aktiviteteve tjera profesionale.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në vitin 2021 ka vlerësuar projektin e ANAK “Integrimi funksional dhe kualitativ i fëmijëve me autizëm dhe vetëdijësi gjithpërfshirës” duke ofruar mbështetje financiare për zbatimin e tij.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në vitin 2022 ka vlerësuar projektin e ANAK “Shërbimi terapeutik për fëmijët me autizëm me sfida socio-ekonomike dhe mirëqenia e prindërve” duke ofruar mbështetje financiare për zbatimin e tij.

Mbështetësit tjerë ndër vite

- **Solidar Suisse (2012-2020)** ka qenë partner i pandashëm i zhvillimit të ANAK që nga viti 2012 duke e mbështetur vazhdimisht me konsulta profesionale dhe financiare. Së bashku me Solidar Suisse ANAK ka avokuar fuqishëm për përfshirjen e pakos eseciale të shërbimeve të nevojshme në planifikimet e sigurimeve shëndetësore.
- **Save the Children (2018-2019)** ‘Ngritja e cilësisë së shërbimeve për autizëm’ - përmes ofrimit të Shërbimeve Multidisiplinare për Fëmijët me Autizëm, në periudhën Korrik 2018 deri në Shtator 2019, me shumën e cili ka qenë i financuar nga Bashkimi Evropian, bashkëfinancuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, dhe zbatuar nga Save the Children Kosovë në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për Politika dhe Hulumtim për Mirëqenie Sociale.
- **Ambasada e Holandës:** duke dhënë mbështetje direkte në shtatë (7) muajt e parë të funksionimit të qendrës për realizimin e projektit “Ura lidhëse drejt integrimit dhe pavarësisht të personave me autizëm” dhe sigurimin e hapsirave të punës në katërmëdhjetë (14) muajt e parë;

- **KFOS:** duke dhënë mbështetje direkte në shtatë (7) muajt e parë të shërbimit për bashkëfinansim të projektit “Ura lidhëse drejt integritit dhe pavarësisht të personave me autizëm”;
- **Shkelzen Maliqi:** duke ofruar zyrën e tij për shfrytëzim në realizimin e shërbimit direkt për një periudhë;
- **Prindërit e fëmijëve me autizëm:** duke kontribuar rregullisht në baza mujore që nga viti 2014 me qëllim të ofrimit të shërbimeve terapeutike për fëmijët me autizëm;
- **Vullnetarizmi i stafit të ANAK dhe studentëve të departamentit të Psikologjisë:** duke dhënë kontributin e tyre në zbatim të aktiviteteve të ndryshme, sidomos gjatë kampanjave vetëdijësuese;
- **Pro Credit Bank:** duke dhënë mbështetje përmes një granti të ofruar i cili është shfrytëzuar për të blerë mjete pedagogjike, dhe mbështetëse e kampanjës “Për njëri tjetrin”.
- **Hamam Jazz Bar:** duke ofruar hapësirën e vet për organizim të ngjarjeve të ndryshme për autizëm, me theks të veçantë në organizime për mbledhje fondesh;
- **Ministria e Punës dhe Mirëqenies Social:** duke dhënë mbështetje gjatë vitit 2014 në mbulim të qerasë së hapësirës së punës dhe blerjen e mjeteve pedagogjike;
- **Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Komuna e Prishtinës:** duke dhënë mbështetje për të ndihmuar familjet që janë në nevojë dhe për mbulim të disa shpenzimeve pedagogjike;
- **Drejtoria për Kulturë, Komuna e Prishtinës:** duke mbështetur kampanjën vetëdijësuese për ndriqim të komunës dhe monumentit NEW BORN me të kaltërt si dhe ka kontribuar në sjelljen e gjeniut Derek Paravicini në vitin 2015;
- **British Council:** duke dhënë mbështetjen në sjelljen e gjeniut me autizëm Derek Paravicini, për të rritur vetëdijësimin mbi aftësitë e autizmit;
- **Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:** duke bashkëkontribuar për të e sjellë gjeniun Derek Paravicini dhe organizimin e aktivitetin e notit për fëmijë, duke financuar një pjesë të materialeve për realizimin e pikturave të kampanjës “Për njëri tjetrin” 2021
- **Hotel Emerald:** duke dhënë hapësirën për koncert nga Derek Paravicini dhe ofrimin e ushqimit dhe pijeve për pjesëmarrësit;
- **Valdete Deva:** duke krijuar mobilje esenciale dhe rekreative për qendrën, veçanërisht në fillimet e punës së ANAK;
- **Aferdita Paqarada:** duke kontribuar me ofrimin e mbështetjes financiare për rastet sociale, shumë e mbledhur nga organizimi i maratonës “Vrapo për autizëm”;
- **Fikrie Gagica Ukelli – Ceka:** duke dhuruar 100 libra me receta, të cilat janë shitur për të mbuluar shpenzimet e nevojshme të ANAK;
- **Ricoh:** duke printuar fotografi me ngjyrë, të cilat janë përdorur për stimulim të komunikimit tek fëmijët;

- **Meridian:** duke dhuruar pije për kampanjë dhe duke kontribuar në organizimin e mbrëmjes për mbledhje të fondeve;
- **Fakulteti AAB:** duke dhënë mbështetje në realizimin e aktivitetit të notit;
- **Ndriqim - Egzoni dhe EZ Vision:** duke kontribuar në ndriçimin e hapësirave publike për nder të 2 prill, ditës ndërkombtare të autizmit.
- **Agjencioni Turk për Bashkëpunim dhe Koordinim - TIKa:** duke kontribuar në rregullimin e qendrës me inventar të plotë;
- **Libraria Dukagjini:** duke ndarë 10% të fitimit të shitjes së librave për mbështetje të shërbimeve emergjente të ANAK.
- **Altina Bytyci:** duke dizajnuar vullnetarisht kampanjën e parë “Për njëri tjetrin”.
- **Diana Deda:** duke dizajnuar kampanjën “Kontribuo për autizëm” dhe kartolinat e kampanjës “Për njëri tjetrin 2021”
- **D.D.D-** kompania dezinfektuese e cila mirëmban duke dezinfektuar ambientet e ANAK në mënyrë vullnetare dhe mbështetëse e kampanjës “Për njëri tjetrin”.
- **NLB Banka-** mbështetëse e kampanjës “Për njëri tjetrin” dhe financuese e programit të pikturës për vitin 2022
- **Ujë Rugove-** duke kontribuar me furnizimin me ujë të pijshëm në organizatë dhe aparatin për ujë që nga viti 2018
- **Banka Ekonomike-** duke dhënë donacion dhe duke shpërndarë pikturat e kampanjës “Për njëri tjetrin” tek bashkëpunëtorët, duke rritur vetëdijësimin për mbështetjen e shërbimeve terapeutike të fëmijëve me autizëm.
- **Ernst & Young Kosova, Kosova Job, A.R Katana, Vatra, American School of Kosova, Semenarna, Rezniqui, Punë n’dorë dhe Trotek:-** duke financuar prodhimin e produkteve të kampanjës “Për njëri tjetrin 2020 në mbështetje të shërbimeve terapeutike të fëmijëve me vështirësi ekonomike pas Covid-19.
- **Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile-** duke blerë produktet e kampanjës “Për njëri tjetrin” në mbështetje të seancave terapeutike të fëmijëve me vështirësi socio-ekonomike pas Covid-19.
- **Byzheteria Fatosi-** duke dhuruar dekorimet e festave të fundvitit në kuadër të kampanjës “Për njëri tjetrin”.
- **OJQ Toka, Dots Consulting, Buqaj, Ndërrmarrja Banesore, Spitali Amerikan, Moneta, Gjirafa Mall, Interex, Ministria e Tregtisë, Digital Station, Honedon, Sach L.L.C-** duke blerë produktet e kampanjës “Për njëri tjetrin” në mbështetje të seancave terapeutike të fëmijëve me vështirësi socio-ekonomike pas Covid-19, dhe me shpërndarjen e atyre produkteve kanë kontribuar në rritjen e vetëdijes për mbështetjen e shërbimeve esenciale të fëmijëve me autizëm.
- **Talat Gjinolli-** duke kontribuar për rreth dy viteve në mënyrë konsistente për shërbimet terapeutike të fëmijëve me autizëm.

- **Raiffeisen Bank**- duke blerë produktet e kampanjës “Për njëri tjetrin” në mbështetje të seancave terapeutike të fëmijëve me vështirësi socio-ekonomike pas Covid-19, mbështetëse në organizimin e eventit “Autizmi dhe talentet” në sjelljen e gjeniut me autizëm Z. Derek Paravicini
- **Shkëmb Gashi**- vullnetarisht ka kontribuar me mbajtje të financave në rast nevojë, në mungesë të personit për tu paguar për një detyrë të tillë në fillim të shërbimeve të ANAK.
- **Moshe Landsman**- përveq mbështetjes së vazhdueshme profesionale dhe emocionale për personelin kyq të ANAK, ai gjithashtu ka kontribuar financiarisht për nevojat emergjente të ANAK pas Covid-19
- **Exfis**- mbështetës konsistent në paraqitjen e nevojave të ndryshme të ANAK.
- **Betim Deva**- duke mbështetur ANAK në proceset e teknologjisë informative.
- **The Idea’s Partnership, TIPUK**- mbështetëse në implementimin e projektit “Seksualiteti dhe Mardhëniet tek Personat me Autizëm”.
- **Mauren Watzel**- kontribuese në trajnimin për staf dhe prindërit mbi njohuritë e integritit të fëmijëve në shkolla dhe duke paisur organizatën me materiale punuese nga Amerika.

